



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:219548  
Datë: 14.01.2025  
Numri i dokumentit: 06709434

**2024:229796**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DIVIZIONI PENAL**, si gjykatë e shkallës së parë penale me gjyqtaren e vetme gjykuese Mimoza Shabani me bashkëpunëtorin profesional Shkëlzen Polloviqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.R. me vendbanim në ... rruga e “...”, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar si: PP.II.nr.1222/24 e datës 20.08.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik me datë 02 Dhjetor 2024, në praninë e përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Ibadete Hamiti, të akuzuarit si dhe të dëmtuarit F.R. me përfaqësues me autorizim Av.Kemajl Ademaj, me datë 04 Dhjetor 2024 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 14 Janar 2025, përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**I.R.** i lindur me datë .... në ..., nga babai H. dhe nëna H., mbiemri i vajzërisë G., me vendbanim në rrugën”.....” në Ferizaj, i martuar, pensioner, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, , me gjendje të mesme ekonomike, me numër personal .....

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse:**

Me datë 22.07.2024, rreth orës 15:30h, në rrugën e .... në ....., saktësisht në rrugë para dyerve të shtëpisë së tij i pandehuri I.R. me qëllim të shkakimit të lëndimit trupor me dashje ka përdorur forcën fizike duke i shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarit F. R. në atë mënyrë që i dëmtuari

ishte ndalur në rrugë me veturë për ta pritur nipin e tij A. R., afrohet i pandehuri me të cilin kishte mosmarrëveshje të më hershme, pronësore ku fillimisht e godet veturën me dorë, afrohet te dritarja e veturës e cila ishte e hapur i drejtohet me fjalët se pse e ka ndalur veturën aty dhe e godet me grushte në kokë, në pjesën e syrin të djathtë duke i shkaktuar lëndime trupore, i cili kërkon tretman mjekësor në Shërbimin Emergjent Primar në ..... dhe nga akt ekspertiza mjekoligjore e datës 12.08.2024 janë konstatuar dëmtime të lehta trupore në pjesën e syrit të djathtë me pasoja të përkohëshme për shëndetin.

- **me të cilin veprim ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga nenin 185 par 1 nën par 1.4 i KPRK-ës.**

Andaj, Gjykata në bazë dispozitës së lartë shënuar si dhe neneve 2, 4, 7, 8, 17, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69 dhe 70 të KPRK-ës, si dhe në bazë të neneve 365, 370 dhe 452 të KPP-ës, të akuzuarin I.R. e,

## **G J Y K O N**

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht.

I dëmtuari F.R., me përfaqësues me autorizim, me vendbanim në .... rruga e “.....”, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € /njëzetë /Euro, si dhe në bazë të nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 dhe nenit 449 par.2 nënpar 2.9 të KPPK-së, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 20 Euro /njëzet euro/, të gjitha brenda afatit prej 30 ditëve, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë, ose do të bëhet përmbarimi i detyruar sipas detyrës zyrtare.

## **A r s y e t i m**

## **Historiku procedurës dhe aktakuza**

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese në çështjen penale kundër të akuzuarit I.R. me vendbanim në .... rruga e “.....”, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar si: PP.II.nr.1222/24 e datës 20.08.2024, duke vepruar në këtë çështje penale në bazë të nenit 240 të KPP-së (Kodi me numër 08/L-032), ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 16 Shtator 2024, në prezencën e prokurorit të shtetit, të akuzuarit dhe të dëmtuarit me përfaqësues me autorizim në të cilin shqyrtim i akuzuari u deklarua i pafajshëm.

Lidhur me këtë gjyqtarja e vetme gjykuese pas kalimit të afatit për paraqitjen e kërkesës për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave ka caktuar shqyrtimin gjyqësor me datë 20 Nëntor 2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, në bazë të nenit 321 të KPP-ës, i ka dhënë mundësinë të akuzuarit që të deklarohet lidhur me fajësinë, dhe në këtë fazë të procedurës penale i akuzuari ka deklaruar se nuk e ndien veten fajtor për këtë veprë penale sepse nuk është e vërtetë që i ka thënë fjalët e përshkruara si në aktakuzë, në të cilën shqyrtim përfaqësuesi i akuzës – Prokurori i Shtetit, me rastin e leximit të aktakuzës, paraqitjes së fjalës hyrëse e deri në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale duke i propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj dënim sipas ligjit.

## **Mbrojtja e të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor**

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtarja e vetme gjykuese e ka udhëzuar dhe njoftuar të akuzuarin për të drejtat dhe detyrimet e tij në kuptim të nenit 319 të KPPK-së. Pasi që i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, në pajtim me nenin 321 të KPPK-së, i ka ofruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari me rastin e deklaramit lidhur me fajësinë apo pafajësinë e tij si në shqyrtimin fillestar ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë dhe nuk e ndien veten fajtor për veprën penale që i është vënë në barrë nga ana e prokurorisë, ndërsa në mbrojtjen e tij ka shfrytëzuar të drejtën e mbrojtjes në heshtje.

### **Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**

Pasi që i akuzuari nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale sipas kësaj akuze, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 360 par.1 dhe 2 të KPPK-ës, vërtetohet gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë: aktekspertimi mjeko-ligjor i datës 1208.2024, së bashku me raportet mjekësore në emër të të dëmtuarit si dhe 2 CD të vendit të ngjarjes të bashkangjitura në raportin fillestar të incidentit me numër rasti 2024-CF-1357 i datës 22 Korrik 2024.

### **Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**

Fillimisht gjykata vlerëson si të pakontestueshme dhe të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

- Se në ditën kritike të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës, i akuzuari është takuar me të dëmtuarin të cilin e ka vëlla dhe kanë pasur kontakt mes vete lidhur me një mosmarrëveshje si dhe nuk e kanë mohuar faktin që kanë pasur probleme edhe më herët mes vete.
- Për gjykatën ishte kontestuese vërtetimi i faktit se i akuzuari a e ka goditur të dëmtuarin siç është përshkruar në aktakuzë dhe a i ka shkaktuar lëndime trupore siç janë përcaktuar në ekspertizë, ku një fakt të tillë i njejtë e ka mohuar dhe nuk e ka pranuar.

Gjyqtarja e vetme gjyqësore për të vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktakuzës ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarës - të dëmtuarin F.R. në shqyrtimin gjyqësorë ka deklaruar se e mbështet deklaratën e dhënë në Stacionin Policor në Ferizaj, dhe se ky rast ka ndodhur gjatë pushimeve sa ka qenë në Kosovë, ku deri sa ishin duke rregulluar një problem në veturën e tij së

bashku me djalën e vëllait të tij A. R., kishin vendosur që ta dërgonin veturën tek elektrikisti dhe pasiqë kanë dal tek dyert e shtëpisë së tij, i njëjti ishte brenda veturës ulur tek shoferi ndërsa A. ishte shkuar të marrë diqka në shtëpinë e tij dhe të i mbyllë dyert e shtëpisë, ku gjatë kësaj kohe i është ofruar i akuzuari të cilin e ka vëlla dhe i ishte drejtuar me fjalë se “përse je ndal këtu dhe përse po e mban veturën dhezë pasiqë nuk lejohet se i pengon fqinjët që janë duke pushuar”, ku ai nuk ka folur asgjë dhe në ato momente i akuzuari e ka goditur me boks në syrin e tij dhe pasiqë ka tentuar ta godasë prap i njëjti nuk e ka lejuar dhe e ka kapur për dore e ka tërhjek në drejtim të tij dhe në ato momente ka ndërhyrë Avniu dhe i ka ndarë dhe kanë vazhduar rrugën ku edhe kanë lajmëruar policinë për rastin.

Krejt në fund i dëmtuari ka deklaruar se asnjëherë nuk kanë pas raporte të mira më herët me vëllain e tij pasiqë kanë probleme pronësore mes vete ku janë duke zhvilluar procedurën civile.

Dëshmitari A. R. në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklaramit të tij dhënë në procedurë hetimore duke shtuar se ditën kritike kur ka ndodhur rasti ka qenë pasditë së bashku me agjin e tij F. i cili kishte problem me veturën e tij dhe pasiqë nuk kishin arritur ta rregullonin kishin vendosur ta dërgonin tek elektrikisti dhe agja i tij kishte hypur në veturë dhe kishte dal ta priste tek rruga deri i njëjti ishte futur në shtëpi të marr diqka personale dhe ndërkohë kishte dëgjuar një zhurmë në rrugë dhe kishte dal të shikonte se qfarë kishte ndodhur dhe tek vetura e F. kishte parë I. i cili ishte ofruar tek xhami ku ishte ulur F. duke i thënë të njëjtit se “çka je ndal këtu, pse e ke ndal veturën këtu” dhe i kishte futur duart në veturë ku e kishte parë të njëjtit duke e goditur F. dhe ishte ofruar që ti ndante dhe i kishte kërkuar I. të hyjë brenda në shtëpi ndërsa së bashku me F. kishin vazhduar rrugën me veturë ku edhe e kishin njoftuar policinë.

Dëshmitari tutje shton se pasiqë kishte hypur në veturë e kishte parë agjën e tij që kishte syrin e mavijosur dhe se i njëjti e kishte goditur në fytyrë dhe se e kishte shoqëruar agjën e tij në stacion policor ku ishin deklaruar për këtë rast.

### **Fjala përfundimtare e palëve**

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se mbetet ne tersi pranë aktit akuzues dhe kualifikimit juridik të veprës penale kundër ta pandehurit, ku pas administrimit të provave gjatë shqyrtimit gjyqësor vlerësoi se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila cilësohet si ne dispozitiv të aktakuzës. Në mënyrë bindëse nga administrimi i provave materiale, video inqizimi i vendit të ngjarjes dëshmime të dëshmitarëve, u vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që akuzohet, andaj ka kërkuar nga gjykata që i njejtë të shpallet fajtor dhe të denohet sipas ligjit duke marrë parasysh si rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë që të arrihet qëllimi i denimit.

Përfaqësuesi me autorizim i palës së dëmtuar në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e mbështetë fjalën e prokurorit të shtetit, i bashkangjiten ndjekjes penale dhe kërkojnë kompensimin e dëmit për atë që i është shkaktuar të mbrojturit të tij.

I dëmtuari në fjalën e tij përfundimtare ka theksuar se e mbështet mbrojtësin e tij si dhe kërkon nga gjykata që ti kompensohet dëmi i shkaktuar si dhe i bashkangjitet ndjekjes penale.

I akuzuari në fjalën e tij përfundimtare ka deklarua se kërkon të lirohet nga kjo vepër penale pasi që nuk e ndihen veten fajtor ndërsa ka kërkuar nga gjykatat që të ketë parasysh moshën e tij të shtyer nëse të njejtit e gjen fajtor për këtë vepër.

Gjykata me kujdes të veçantë vlerësoi fjalët përfundimtare të palëve në procedurë, fjala përfundimtare e prokurorit të shtetit gjykata e vlerësoi si të argumentueshme dhe që gjen mbështetje në provat materiale si dhe rrjedhin e procedurës penale që nga shqyrtimi fillestar dhe në shqyrtim gjyqësor.

### **Vlerësimi i provave nga ana e gjykatës**

Gjykata me rastin e vlerësimit të dëshmisë së të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit vërtetoi faktin se i akuzuari në kohë vend dhe mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës e ka goditur të njejtin dhe i ka shkaktuar lëndime ku pretendimi i të dëmtuarit gjen mbështetje edhe në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës dhe atë ekspertizës mjeko-ligjore në të cilën është konstatuar se i dëmtuari ka pësuar lëndime trupore si dhe në bazë të video inqizimit të vendit të ngjarjes vërtetohet se këto lëndime i dëmtuari i ka marr nga tani i akuzuari i cili shihet qartë në video inqizimin momenti kur i ofrohet të dëmtuarit tek vetura e tij dhe duke e futur dorën në

veturë ku ishte ulur i njëjti e godet gjë e cila u vërtetua edhe nga dëshmia e dëshmitarit i dëgjuar në shqyrtim gjyqësor, andaj nga të gjitha këto gjykata vërtetohet se me veprimet e tij i akuzuari ka përmbushur elementet thelbësore të veprës penale që akuzohet e me të cilat veprime i ka shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarit.

Andaj, gjykata dëshmisë dëshmitarit - të dëmtuarit ia shpreh besimin e plotë për faktin se dëshmitari në mënyrë të sinqertë dhe të drejtë e ka rrëfyer tërë kronologjinë e rastit, duke e ndërlidhur të gjitha provat në mes vete ka ardhur në përfundim se gjendja faktike është vërtetuar si në dispozitiv të aktakuzës.

Gjykata me kujdes shqyrtoi edhe dëshminë e dëshmitarit A. I. e cila ishte prezent në ditën kritike kur kishte ndodhur ngjarja dhe e kishte parë se si kishte ndodhur rasti dhe gjykata i fal besimin kësaj dëshmie për shkak një dëshmi e tillë është në përputhje edhe në dëshminë e dhënë në procedurë paraprake, andaj gjykata vlerëson se edhe kjo dëshmi është në përputhje me provat e tjera materiale e edhe në dëshminë e të dëmtuarit.

Gjykata në cilësi të provave materiale administroi edhe Raportin e vendit të ngjarjes me numër rasti 2023-CF-1811 i datës 18.08.2023 së bashku me CD në vendin e ngjarjes, ku vërtetohet se i akuzuari i është ofruar tek vetura e të dëmtuarin dhe e ka goditur duke i shkaktuar lëndime trupore.

### **Vlerësimi i gjykatës sa i përket veprës penale**

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit janë plotësuar të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën është akuzuar, e që po ashtu në veprimet e të akuzuarit janë plotësuar elementet e përgjithshme dhe të veçanta të figurës së veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-ës.

Gjykata gjatë trajtimit të kësaj çështje juridiko-penale pati parasysh faktin se kemi të bëjmë me një vepër penale e cila hyn në Kapitullin e veprave penale kundër jetës dhe trupit , andaj edhe në këtë rast kemi të bëjmë me integritetin trupor që ligjvënësi ofron mbrojtje të veçantë ligjore.

Andaj, gjykata ofroj një kujdese të veçantë sepse pati parasysh faktin se përmes dënimit të veprave penale të kësaj natyre do të zvogëlohet edhe numri i kësaj dukurie e cila është shumë e shpeshtë kohëve të fundit, gjithashtu duke marrë parasysh rastin konkretë që rast ka ndodhur për

shkak të mosmarrëveshjes pronësore andaj me një dënim të tillë ti ofrohet një kujdes i veçantë palës së dëmtuar.

### **Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe masën e dënimit**

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjyqtarja i vetme gjykuese, vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim 69 dhe 70 të KPRK-së, që matja e dënimit të bëhet edhe në proporcion me peshën e veprës penale dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryesit andaj në rastin konkret duke marrë për bazë si rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë që dënimi të jetë më i butë apo më i rëndë, andaj në rastin konkret nuk gjeti rrethana veçanërisht lehtësuese ndërsa si rrethanë lehtësuese pati moshën e të akuzuarit, ndërsa me rastin e vlerësimi të rrethanave rënduese gjykata vlerësoi intensitetin e rrezikimit apo i dëmtimit të së mirës së mbrojtur pasi që bëhet fjalë për veprë penale kundër jetës dhe trupit.

Mbi bazën e këtyre rrethanave, gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit, duke marrë parasysh se me dënim të kushtëzuar do të arrihet qëllimi i dënimit kështu që me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë veprës penale dhe kryerësit, që do të shërbejë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që t'i përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

### **Shpenzimet e procedurës dhe kërkesa pasurore-juridike**

Gjykata është kujdesur veçanërisht për kërkesën pasurore juridike të dëmtuarit si një e drejtë që i takon me ligj, por meqenëse i dëmtuari nuk ka mundur të precizojë të njëjtën në shqyrtim gjyqësor, gjykata me të drejtë të njëjtin e udhëzon që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest civil.



Vendimi mbi shpenzimet procedurës gjyqësore është marr në kuptim të dispozitës së nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 dhe nenit 449 par.2 nënpar 2.9 të KPPK-së për kompensimin e viktimave të krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**Departamenti Përgjithshëm Penal,**

**2024:229796 e datës 14 Janar 2024**

**Bashkëpunëtor profesional,**

Shkëlzen Polloviqi

**Gjyqtarja,**

Mimoza SHABANI

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e parë e ardhshme pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.